2-180/6007
06 08 2026

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës
Nr. 002/40
Datë: 31.07.2026

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, (LVL) Nr. 03/L-040, neni 12 paragrafi 12.2 pika d), Statutit të Komunës së Junikut (të datës 29.9.2010), neni 22 paragrafi 22.1 pika 4, Kuvendi Komunal në Junik në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 31.07.2026, mori këtë:

VENDIM
për themelimin e komisionit për emërtimin e zonave të qarkullimit publik

I. Me këtë vendim themelohet komisioni për emërtimin e zonave të qarkullimit publik në komunën e Junikut.

II. Me shprehjen " zonë e qarkullimit publik" nënkuptohet pjesa e territorit publik si: bulevardet, rrugët, rrugicat, sheshet, parqet dhe unazat rrugore.

III. Për mbarëvajtjen e punës së komisionit, i njëjti harton: planin e punës, rregulloren e punës dhe raportin e punës.

IV. Të gjitha projekt dokumentet nga pika III e këtij vendimi i procedohen kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim.

V. Projekt plani i punës së komisionit duhet ti procedohet kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim më se largu 30 ditë pas themelimit të komisionit.

VI. Komisioni përbehet nga 5 anëtarë. Nga 1 anëtar nga secili subjekt politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Komunës dhe anëtari i pavarur, ndërsa 1 nga ekzekutivi i Komunës.

1.Bedrush Hoxha – Anëtar nga Kuvendi i Komunës së Junikut nga LDK-ja,
2.Burim Kuçi – Anëtar nga Kuvendi i Komunës së Junikut nga AAK-ja,
3.Elsa Hima – Anëtare nga Kuvendi i Komunës së Junikut nga LVV-ja,
4.Zenun Shala – Anëtar nga Ekzekutivi i Komunës së Junikut,
5.Nezir Shehu – Anëtar i pavarur, Historian.

VII. Propozimet nga pika VI e këtij vendimi duhet t'i behën kryesuesit të Kuvendit të komunës me se largu 30 dit nga dita e nënshkrimit të këtij vendimi.

VIII. Komisioni është organ këshillëdhënës, kurse për punën e tij i përgjigjet Kuvendit të komunës.

IX. Mbledhjet e komisionit i udhëheq kryetari i komisionit i cili do të zgjidhet në mbledhjen inauguruese të komisionit.

X. Kryetari i Komisionit zgjidhet sipas nenit 8 paragrafi 8.7 të Rregullores për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës së Junikut.

XI. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhen zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL,
- Anëtarët e këtij Komisioni,
- Drejtoria për Gjeodozi,Urbanizëm dhe Kadastër,
- Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
z.Leonard Ilolluni